



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

KOMISIONI I HARTIMIT TË PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 4215 Prof.

Ballsh, më 10.09.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 35 Datë 10.09.2025

PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028

-KËSHILLIT TË BASHKISË

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 "Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore për arsimin parauniversitar", si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 20, datë 13.08.2025 "Për vitin shkollor 2025-2026 në sistemin arsimor parauniversitar", si dhe të Urdhrit nr. 189, datë 01.07.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar",

PROPOZOJ:

1. Miratimin e "Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028", sipas dokumentit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Kulturës, Turizmit, Arsimit dhe Shëndetësisë, kopshtet e Bashkisë Mallakastër, si dhe të gjitha strukturat përgjegjëse të përmendura në tekstin e këtij plani për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Projekt-vendim shoqërohet me relacion shpjegues.
4. Ky vendim hyn në fuqi në bazë të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Për komisionin e hartimit të Planit të Arsimit Parauniversitar

Specialist Jurist: A.Heqimaj

Përgj/Sektorit të Shërbimit Social: K. Hoxhaj

Dr/Kulturës, Turizmit, Arsimit dhe Shëndetësisë: N.Dervishaj

Dr/Qendrës Kulturore të Fëmijëve: E.Merkaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA MALLAKASTËR

KOMISIONI I HARTIMIT TË PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 4215 / Prot.

Ballsh, më 10.09.2025

MIRATOHET
KRYETAR
Qerim Ismailaj



**RELACION SHPJEGUES MBI PROJEKT-VENDIMIN " PËR MIRATIMIN E
PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028"**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 "Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore për arsimin parauniversitar", si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 20, datë 13.08.2025 "Për vitin shkollor 2025-2026 në sistemin arsimor parauniversitar", grupi i punës i ngritur me Urdhërin nr. 189, datë 01.07.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar", të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, ka anëtarësi gjithëpërfshirëse (përfaqësues nga të gjitha strukturat e Bashkisë Mallakastër, përfaqësues nga Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare, përfaqësues nga secila shkollë, përfaqësues nga secili kopsht, përfaqësues nga bordet e prindërve), ku çdo anëtar mori pjesë në organizimin e punës dhe në metodologjinë në bazë të së cilës u hartua projekt plani i Arsimit Parauniversitar 2026-2028.

Qëllimi i planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028, është të përmirësojë cilësinë e arsimit parauniversitar publik në Bashkinë Mallakastër, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një baze të dhënash efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit.

Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin Njësi Vendore, prindërit dhe komunitetin. Dokumenti gjithashtu përfshin: 1. Qëllimet dhe Objektivat Strategjike të Planit (parashikojë dhe planifikojë nevojat arsimore të komunitetit në nivel lokal, përmirësojë infrastrukturën dhe mjediset mësimore për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve, garantojë arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët, pa dallim vendbanimi apo statusi social, integrojë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit

në procesin mësimor, krijojë një sistem monitorimi dhe vlerësimi efektiv për zbatimin e planit) , duke përcaktuar gjithashtu strukturat përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e tij.

Plani është shtrirë në të gjitha institucionet arsimore nën juridiksionin e Bashkisë Mallakastër dhe do të monitorohet nga Drejtoria e Kulturës, Turizmit, Arsimit dhe Shëndetësisë, kopshtet e Bashkisë Mallakastër, si dhe të gjitha strukturat përgjegjëse të përmendura në tekstin e këtij plani për zbatimin e këtij vendimi, me qëllim përmirësimin e shërbimeve arsimore për të gjithë fëmijët në këtë zonë.

Plani i Arsimit Parauniversitar 2026-2028 është shprehje e vullnetit nga ana e Bashkisë Mallakastër me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, në ushtrimin e funksioneve të saj publike në fushën e arsimit duke vendosur rregulla të përgjithshme të detyrueshme për zbatim.

Ky plan përfaqëson norma, standarde dhe rregulla të cilat i nënshtrohen konsultimit publik dhe verifikimit të bazueshmërisë ligjore në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.

Për komisionin e hartimit të Planit të Arsimit Parauniversitar

Specialist Jurist: A.Heqimaj



Përgj/Spektori të Shërbimit Social: K. Hoxhaj



Dr/Kulturës, Turizmit, Arsimit dhe Shëndetësisë: N. Dervishaj



Dr/Qendrës Kulturore të Fëmijëve: E. Merkaj





BASHKIA MALLAKASTËR

**PLANI I ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

2026-2028

Përmbajtja:

Parathënie
1. Hyrje dhe konteksti
• Profili demografik dhe social i Bashkisë:
• Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor:	8
2. Përmbledhje Ekzekutive	9
• Qëllimi i Planit të Arsimit Parauniversitar:	9
• Prioritetet kryesore	10
3. Analiza e shërbimit të Arsimit Parauniversitar	11
• Arsimi parashkollor:	11
• Arsimi bazë:	14
• Arsimi i mesëm:	15
• Përmbledhje analitike e sfidave të ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor, bazë dhe atij të mesëm.	17
4. Shërbimi i Arsimit bazë dhe të mesëm sipas njësive administrative.	17
5. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar.	21
6. Planifikimi i burimeve financiare	22
• Burimet financiare vendore:	22
• Burime financimi të tjera	25
7. Përmbledhje e investimeve kapitale:	26
8. Monitorimi dhe Vlerësimi	28
9. Rishikimi dhe përshtatja e planit	30
10. Raportimi dhe transparenca	31
11. Aneksë:	32
Të dhëna demografike dhe statistikore	32
KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATIV	33

Parathënie

Arsimi mbetet themeli mbi të cilin ngrihet mirëqenia dhe zhvillimi i qëndrueshëm i një komuniteti. Në Bashkinë Mallakastër ku historia dhe traditat ndërthuren me sfidat e kohës, siguria e aksesit të barabartë në arsim cilësor është një e drejtë që kërkon vëmendje dhe angazhim të vazhdueshëm. Ky plan i arsimit parauniversitar përfaqëson një hap të rëndësishëm në rrugën drejt një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, funksional dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të çdo fëmije e familjeje në territorin tonë.

Duke u mbështetur në analizën e situatës aktuale dhe dialogun me komunitetin, prindërit, mësuesit dhe aktorët lokal, ky dokument synon të përcaktojë drejtimet strategjike për zhvillimin e arsimit në Mallakastër, si një mjet për të garantuar barazi dhe për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt për brezat që vijnë.

Vizioni ynë:

“Të ndërtojmë një sistem arsimor parauniversitar gjithëpërfshirës, të aksesueshëm dhe cilësor për çdo fëmijë të Bashkisë Mallakastër, duke u mbështetur mbi planifikim të kujdesshëm, investime në infrastrukturë dhe përmirësim të vazhdueshëm të burimeve njerëzore, me synim sigurimin e mundësive të barabarta për të gjithë.”

Ky plan nuk është thjesht një dokument, por një angazhim i Bashkisë Mallakastër për të qenë pranë çdo nxënësi, çdo edukatori e çdo prindi, në mënyrë që së bashku të ndërtojmë një arsim më të drejtë dhe më cilësor për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Me respekt,

Kryetar i Bashkisë

Qerim Ismailaj

1. Hyrje dhe konteksti

• Profili demografik dhe social i Bashkisë:

Bashkia Mallakastër ndodhet në qarkun e Fierit dhe përfshin një territor me karakter kryesisht kondrinor- malor. Struktura demografike karakterizohet nga një tendencë e migrimit të brendshëm e të jashtëm, duke sjellë ulje të numrit të nxënësve në disa zona rurale. Ajo përfshin 9 (nëntë) njësi administrative: Ballsh (qendra e bashkisë), Aranitas, Fratar, Greshicë, Hekal, Kutë, Ngraçan, Qendër dhe Selitë.

Në aspektin social, komuniteti i Mallakastrës vlerësohet për traditën arsimore dhe kulturore, përfshirjen e familjeve në edukimin e fëmijëve dhe lidhjen e ngushtë me shkollën si institucion bazë i jetës shoqërore.

Popullsia në moshë shkollore, përbën një pjesë të rëndësishme të komunitetit, duke nxitur nevojën për përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe të shërbimeve rinore në të gjitha njësitë administrative. Bashkia garanton akses të barabartë në arsim, aktivitete kulturore dhe gjithpërfshirje sociale për të rinjtë.

Ndërthurja e zonave urbane dhe rurale kërkon një planifikim të shërbimeve, me synim mbulimin sa më efektiv të nevojave për edukim, transport, infrastrukturë, pajisje dhe burime njerëzore.

Bashkia është e përkushtuar në ofrimin e shërbimeve për të gjitha grupmoshat, si në nxitjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale, kulturore dhe vendimmarrëse të komunitetit.

Megjithëse sfida mbeten kushtet infrastrukturore, shërbimet mbështetëse për arsimin parashkollor dhe nevoja për investime në teknologji dhe mjedise bashkëkohore të të nxënit.

Territori i Bashkisë shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 329.04 km² dhe përfshin qytetin e Ballshit si qendër administrative, së bashku me 41 fshatra.

Nga pikëpamja demografike dhe sociale, Bashkia Mallakastër përballet me sfida të lidhura me migrimin dhe emigrimin, por gjithashtu ruan një përqindje të konsiderueshme të fëmijëve dhe të rinjve.

Të dhëna demografike

Popullsia e përgjithshme në Mallakastër arrin rreth 15,838 banorë, sipas Censurit 2023 me një përqendrim më të lartë në zonën e Ballshit.


Të dhëna administrative	Vlerë
Sipërfaqja	329.04 km ²
Popullsia e bashkisë	15838 banorë
Popullsia qyteti Ballsh	4944 banorë
Njësi administrative	9 (Ballsh, Aramitas, Fratar, Greshicë, Hekal, Kutë, Ngraçan, Qendër, Selitë)
Fshatra të përfshira	41 fshatra përmes njësive administrative

Përshkrim Demografik sipas njësive administrative në Bashkinë Mallakastër.

Tabela e mëposhtme pasqyron numrin e banorëve për tre grupmoshat, ku vihet re që numri me popullatën më të madhe është grupmosha 15-64 vjeç me 10800 banorë.


Grupmosha	Numri i banorëve
0-14 vjeç	2600
15-64 vjeç	10800
Mbi 65 vjeç	2400

Numri banorëve sipas grupmoshave: 0-14 vjeç, 15-64 vjeç, mbi 65 vjeç




Numri i banorëve sipas njësive administrative në Bashkinë Mallakastër

Njësiti administrative	Gjinia	Numri
Ballsh + Ngraçan	Femra	5537
	Meshkuj	5924
Qendër	Femra	3962
	Meshkuj	4523
Hekal	Femra	2185
	Meshkuj	2466
Aranitas	Femra	1771
	Meshkuj	2075
Fratar + Selitë	Femra	2862
	Meshkuj	3229
Kutë	Femra	1410
	Meshkuj	1590
Greshicë	Femra	858
	Meshkuj	949



Paraqitja grafike e numrit të banorëve (femra, meshkuj) në njësitë administrative, Bashkia Mallakastër



Në grafikët e mësipërm, bazuar në të dhënat e INSTAT, me numrin më të madh të banorëve është Ballsh-Ngraçan, dhe njësia me numrin më të vogël është Greshica me 1807 banorë, po bazuar në këto të dhëna numrin më të vogël të banorëve femra e ka Greshica.

Sfidat në nivel lokal

Për Bashkinë Mallakastër, sfidat në nivel lokal lidhen si me aspektet infrastrukturore, burimet njerëzore ashtu dhe me faktorë social-ekonomik.

Infrastruktura arsimore:

Shkolla të amortizuara: Disa ndërtesa shkollore janë të vjetra, kërkojnë rikonstruksion ose investime në kushte higjiëno-sanitare.

Shkolla të shpërndara në fshatra me numër të ulët nxënësish. Mungesë mjediesh sportive dhe laboratorike, që kufizon zhvillimin gjithëpërfshirës të nxënësve.

Burimet njerëzore: Nevoja për trajnime të vazhdueshme mbi teknologjinë, metodat bashkëkohore të mësimdhënies.

Demografia dhe migracioni: Ulje e numrit të nxënësve për shkak të emigrimit dhe migrimit.

Teknologjia dhe mjetet mësimore: Mungesë pajisjesh digjitale në shumë shkolla. Vështirësi në aksesimin e internetit në disa zona të thella.

- **Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor:**

Kuadri ligjor dhe politika që përfaqëson bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë e arsimit në nivel vendor.

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Mallakastër në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike për garantimin e të drejtës për arsim siç janë:

Akte kushtetuese dhe ligjore

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

-Neni 57, pika 1, “Kushdo ka të drejtën për arsimim”Kjo e drejtë përbën bazën mbi të cilën ndërtohen politikat dhe funksionet publike në arsim.

- **Ligji nr. 69/2012, i ndryshuar, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”**

Rregullon sistemin arsimor dhe përfshin bashkitë si ofrues të shërbimeve ndihmëse (logjistikë, kushte mjedisore, siguri, transport) për institucionet parashkollore dhe bazë.

- **Ligji nr. 48/2018, “Ligj për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”**

-Përcakton strukturën dhe funksionimin e sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore.

- **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**

- Nenet 22 dhe 23: E kategorizon arsimin paruniversitar si funksion i deleguar, duke ngarkuar bashkitë me detyra për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë dhe të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës në institucionet arsimore.

- **Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**

- Përcakton rolin e njërive të vetëqeverisjes vendore në parandalimin e braktisjes së shkollës, për mbështetjen e fëmijëve në nevojë dhe parandalimin e përjashtimit social.

- **Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor.**

Në nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore dhe udhëzimesh mbështetëse.

- Ndër më të rëndësishmet është **Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020**, që miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe **Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023**, që përcakton normat për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore për mësuesit. Po ashtu, **Udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr.20 datë 13.08.2025 “Për vitin shkollor 2025-2026 në Sistemin Arsimor Parauniversitar”**, përcakton masat dhe veprimtari që ndërmarrin institucionet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2025-2026 ndërsa **Udhëzimi nr.25, datë 25.07.2018**, përcakton ngritjen dhe funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore, si mekanizma pjesëmarrjeje dhe monitorimi.

Një dokument me rëndësi për cilësinë e arsimit parashkollor është edhe **Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024**, që miraton Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshteve.

Në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Bashkia Mallakastër udhëhiqet gjithashtu nga udhëzime specifike si **Udhëzimi nr.21, datë 08.08.2014**, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë, dhe Plani Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, përbëjnë udhërrëfyes për politikën lokale në territorin e Bashkisë Mallakastër.

Një fushë me rëndësi të veçantë është edhe ofrimi i shërbimit psiko-social në shkollë, i cili rregullohet me **Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020**, si dhe me udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor, të hartuar për stafet e bashkive dhe të zyrave vendore arsimore. Gjithashtu, për të garantuar një ambient të sigurt dixhital për fëmijët, zbatohet Udhëzimi i përbashkët MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, i cili përcakton masa për mbrojtjen e tyre nga përmbajtjet e dëmshme në internet.

Nëpërmjet këtij kuadri të gjerë ligjor dhe politik, Bashkia Mallakastër vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore dhe sociale, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve në territorin e saj. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Zyrën Vendore Arsimore dhe institucionet e tjera publike, synohet ndërtimi i një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë.

2. Përmbledhje Ekzekutive

- **Qëllimi i Planit të Arsimit Parauniversitar:**

Plani i Arsimit Parauniversitar është një dokument i hartuar në nivel lokal dhe qëllimi i tij është të sigurojë akses të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor në arsim për të gjithë nxënësit pavarësisht vendbanimit, gjinisë, statusit social apo aftësive të tyre.

Ky plan synon të:

- parashikojë dhe planifikojë nevojat arsimore të komunitetit në nivel lokal.,
- përmirësojë infrastrukturën dhe mjediset mësimore për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit.,
- garantojë arsim të barabartë dhe gjithpërfshirës për të gjithë fëmijët, pa dallim vendbanimi apo statusi social.,
- integrojë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në procesin mësimor.
- krijojë një sistem monitorimi dhe vlerësimi efektiv për zbatimin e planit

Arsimi, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Mallakastër.

Aspekte të shërbimit që adreson Plani i Arsimit Parauniversitar.

Proceset e menaxhimit:

- Gjithpërfshirja: Planifikimi dhe regjistrimi i fëmijëve.
- Organizmat e institucionit arsimor.
- Financimi.

Proceset kryesore:

- Përfshirja sociale.
- Mbrojtja e fëmijëve.
- Fëmijët me aftësi ndryshe.

Proceset mbështetëse:

- Menaxhimi i godinave
- Burimet njerëzore.
- Materialet dhe shërbime mbështetëse.

• Prioritetet kryesore

Në kuadër të hartimit dhe zbatimit të një plani efektiv për arsimin parauniversitar në nivel bashkie, në përputhje me strategjinë kombëtare të arsimit dhe nevojat e territorit, prioritetet e Bashkisë Mallakastër në fushën e arsimit parauniversitar janë:

1. Rritja e aksesit dhe përfshirjes- Sigurimi i kushteve që çdo fëmijë i moshës shkollore të ndjekë arsimin parashkollor dhe bazë, duke reduktuar braktisjen dhe duke nxitur pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve në mënyrë të barabartë.
2. Hartimi i politikave dhe planifikimeve strategjike lokale me fokus përmirësimin e shërbimeve arsimore në të gjitha zonat e juridiksionit të Bashkisë Mallakastër, duke nxitur përfshirjen, barazinë në arsim dhe aksesin për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë.
3. Bashkëpunimi ndërinstitucional, pjesëmarrja e komunitetit, prindërve dhe përfshirja e përvojave më të mira, në funksion të një menaxhimi efektiv të sistemit arsimor parauniversitar në të gjitha nivelet e tij.

4. Investimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore, rritja e cilësisë së shërbimit në institucionet arsimore, zhvillimi profesional i mësuesve si dhe fuqizimi i bashkëpunimit me komunitetin në funksion të edukimit gjithëpërfshirës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të qytetarëve aktivë.

3. Analiza e shërbimit të Arsimit Parauniversitar

- **Arsimi parashkollor:**


Reforma territoriale dhe miratimi i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i dhanë pushtetit lokal, kompetencën për administrimin e institucioneve të arsimit parashkollor: çerdheve dhe kopshteve. Këto institucione janë pjesë e shërbimeve që bashkia ofron për zhvillimin social dhe arsimor të komunitetit. Nga viti 2018, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.48/2018 “Për arsimin dhe kujdesin për fëmijërinë e hershme”, i ndryshuar është përcaktuar qartë se arsimi parashkollor (0-6vjeç) është pjesë integrale e sistemit arsimor shqiptar dhe përfshin dy hallka:

- çerdhet (0-3 vjeç) që janë në administrim të plotë të pushtetit vendor
- kopshtet (3-6 vjeç) që administrohen nga bashkia, por me mbështetje metodologjike dhe standarte nga Ministria e Arsimit dhe Sportit

Në Bashkinë Mallakastër shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Aktualisht Bashkia Mallakastër ka në funksionalitetin e saj 26 kopshte (si institucione arsimore parashkollore më vete dhe/ose grupe brenda/jashtë godinave të institucioneve arsimore parauniversitare) të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Për vitin 2024, 323 fëmijë kanë ndjekur institucionet parashkollore (kopshtin), konkretisht 166 vajza dhe 157 djem kurse në zonat rurale kanë frekuentuar 203 fëmijë (108 femra dhe 95 meshkuj).

Viti 2023 - 2024			
	Nr. total i fëmijëve	Femra	Meshkuj
Zona urbane	120	58	62
Zonat rurale	203	108	95


Numri total i fëmijëve frekuentues për periudhën 2023-2024 në Bashkinë Mallakastër



Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat rurale.

Shpërndarja e kopshteve sipas njësive administrative

Nr.	Njësia administrative	Numri i kopshteve
1	Ballsh	4
2	Qendër Dukas	8
3	Hekal	3
4	Fratar	2
5	Aranitas	2
6	Ngraçan	1
7	Kutë	3
8	Greshicë	1
9	Selitë	2



Për periudhën Shtator 2024 e në vazhdim në Bashkinë Mallakastër funksionojnë 26 kopshte, ku nga këto ofrohet arsim parashkollor në 18 godina të mjediseve të shkollave të arsimit bazë dhe të tjerat jashtë mjediseve të shkollave.

Në zonën urbane të Bashkisë Mallakastër kryejnë funksionin e tyre dy kopshte me drejtori më vete nga të cilat:

- 1 kopsht pa ushqim (Kopshti Nr.1)
- 1 kopsht me ushqim (Kopshti Nr.2)

Grupet përgatitore ndodhen përkatësisht në shkollën:

- “9-Dëshmorët“ Bejar 1 grup,
- “Ismail Klosi“ Ballsh 1 grup,
- “5 Shkurti” Ballsh 2 grupe.

Identifikimi i sfidave dhe mundësive për përmirësim në përputhje me standartet kombëtare apo vendore

- Krijimi i kushteve më të përshtatshme dhe ndërhyrje në infrastrukturë për të nxitur zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
- Sigurimi i stafit profesional dhe i trajnuar për arsimin parashkollor.
- Standartizimi i materialeve mësimore dhe edukative në funksion të lojërave bashkëkohore dhe zhvillimit gjithëpërfshirës
- Nxitja e përfshirjes së fëmijëve nga komunitete në nevojë, si romë, egjiptian apo fëmijë me aftësi ndryshe.
- Hartimi i programeve që garantojnë pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe monitorimin e fëmijëve që i përkasin grupeve vulnerabël.
- Partneritete me organizata dhe projekte që synojnë zhvillimin e hershëm të fëmijëve.


• **Arsimi bazë:**

Sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, bashkia ka kompetenca të deleguara dhe përgjegjësi të drejtpërdrejta për menaxhimin e arsimit bazë në territorin e saj. Funksionet kryesore përfshijnë aspekte që lidhen me administrimin e infrastrukturës shkollore, e cila përfshin menaxhimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e godinave të arsimit bazë.

Pushteti vendor investon në sigurimin e kushteve bazë për funksionimin normal të institucioneve arsimore, duke përfshirë ngrohjen, furnizimin me ujë, higjienën, ndriçimin dhe sigurinë në shkolla. Në rastet kur shfaqet nevoja për ndërtimin e ambienteve të reja, bashkia harton projekte përkatëse dhe ndërmer masat për zbatimin e tyre. Kuadri ligjor i ngarkon njësitë të qeverisjes vendore përgjegjësinë edhe për sigurimin e shërbimeve ndihmëse të tilla si: transport i sigurt për nxënësit, mbulimi me shërbime sanitare, ngrohja në institucionet arsimore, furnizimi me ujë të pijshëm dhe ofrimi i mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta.

Në arsimin 9-vjeçar, nga klasa e 1-9 janë të regjistruar gjithsej 1347 nxënës, nga të cilët 640 janë femra dhe 707 meshkuj.

Shkolla 9-vjeçare			
Klasat	Nxënës	Femra	Meshkuj
I-IX	1347	640	707




Identifikimi i sfidave dhe mundësive për përmirësim në raport me standartet apo objektivat vendore

- Pushteti vendor përballet me kufizime buxhetore për shkak se varen nga fondet qendrore.
- Fuqizimi i kapaciteteve teknike dhe menaxheriale për planifikim dhe zbatim të projekteve arsimore
- Pjesëmarrje e kufizuar e komunitetit dhe prindërve në vendimmarrjen lokale për arsimin.
- Sigurimi i materialeve bashkëkohore për procesin mësimor.
- Rritja e cilësisë së shërbimeve arsimore për fëmijët me aftësi ndryshe dhe përfshirja e komunitetit romë dhe egjiptianë.

• Arsimi i mesëm:

Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, faktorët social dhe ekonomik. Bashkia Mallakastër ka gjithsej 3 shkolla të arsimit të mesëm, nga të cilat, 2 gjenden në zonat rurale dhe 1 në zonën urbane. Institucionet e arsimit të mesëm janë të dy tipologjive: si gjimnaze dhe si shkolla të mesme të bashkuara.



Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 509 nxënës, (249 femra dhe 260 meshkuj) nga të cilët 364 në zonën urbane dhe 145 në zonat rurale.

Shkolla e mesme			
Klasat	Nxënës	Femra	Meshkuj
X-XII	509	249	260

Në vitet e fundit vërehet një rënie e zvogëlimit të numrit të nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm të lartë si rezultat i tkurrjes së popullsisë rezidente, për shkak të uljes së lindshmërisë si dhe për shkak të migrameve.

Pavarësisht se arsimi i mesëm është përgjegjësi kryesore e Ministrisë së Arsimit dhe strukturave të saj vartëse, siç janë njësitë arsimore vendore, pushteti vendor ka rol të rëndësishëm mbështetës, veçanërisht në aspektin infrastrukturor, logjistik dhe të shërbimeve ndihmëse. Bashkia Mallakastër është përgjegjëse për mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe pjesërisht ndërtimin e godinave të arsimit të mesëm në territorin e saj, në bashkëpunim me qeverinë qendrore. Shërbimet mbështetëse përfshijnë furnizimin me ujë të pijshëm, ngrohjen gjatë stinës së dimrit, masat për sigurinë në shkollë, higjienën, transportin, aksesin për nxënësit me aftësi ndryshe si dhe ofrimin e mbështetjes sociale për nxënësit në nevojë. Gjithashtu bashkia siguron mjedise të sigurta funksionale edhe për stafin mësimor duke garantuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor.

Bashkia Mallakastër bashkëpunon me Zyrën Vendore Arsimore për komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me drejtuesit e shkollave për identifikimin e nevojave emergjente dhe ato të planifikuara që lidhen me mirëmbajtjen ose ndërhyrjet infrastrukturore.

Në kuadër të bashkëpunimit me shkollat dhe komunitetin, bashkia luan rol në mbështetjen e orientimit në karrierë dhe zhvillimin e veprimtarive jashtëshkollore. Gjithashtu bashkia mbështet dhe organizimin e aktiviteteve kulturore, sociale dhe qytetare me shkollat e mesme.

Sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimeve mbështetëse.

- Kufizimi i buxhetit për arsimin e mesëm.
- Shërbime mbështetëse të kufizuara (transport, bibliotekë, shëndetësi, teknologji, etj).
- Kosto e lartë për modernizimin me pajisje teknologjike bashkëkohore.
- Vështirësi në sigurimin e kushteve të transportit dhe infrastrukturës për nxënësit e zonave rurale.

• **Përmbledhje analitike e sfidave të ofrimit të shërbimit të arsimit.**

Përmbledhje analitike e arsimit parauniversitar pasqyron faktorët që lidhen me:


- **Infrastrukturën** - Pjesa më e madhe e godinave shkollore janë funksionale, megjithëse një pjesë e tyre paraqesin nevoja për ndërhyrje në rikonstruksion të pjesshëm ose të plotë, sidomos për sa i përket sistemit të ngrohjes, hidroizolimit dhe përmirësimit të ambienteve sanitare. Shkollat qendër të cilat mbulojnë një numër më të madh nxënësish, në përgjithësi kanë kushte më të mira infrastrukturore, ndërsa disa nga shkollat vartëse, të vendosura në zonat rurale, paraqesin problematika më të dukshme, si mungesa e hapësirave funksionale, amortizimi i godinave dhe nevoja për pajisje didaktike bashkëkohore. Në vitet e fundit janë ndërmarrë disa projekte rikonstruksioni dhe investime në pajisje didaktike, teknologji por nevojitet një angazhim i mëtejshëm për të garantuar kushte të barabarta infrastrukturore në të gjitha institucionet arsimore të bashkisë.
- **Burimet njerëzore** - Për të garantuar zhvillimin normal të procesit mësimor dhe edukativ, në institucionet arsimore janë të angazhuar punonjës ndihmës, të cilët mbështesin punën e stafit mësimor. Për garantimin e sigurisë së nxënësve dhe mbarëvajtjen e orarit mësimor, pranë shkollave janë të angazhuar oficerë të sigurisë. Ky bashkëpunim ka ndihmuar në krijimin e një mjedisi më të sigurt, duke kontribuar në rritjen e disiplinës dhe parandalimin e problematikave të ndryshme.
- **Përfshirjen e nxënësve** - Në këto institucione arsimore janë të regjistruar:
 - 53 fëmijë me Aftësi Ndryshe, të cilët marrin mbështetje për integrim dhe zhvillim të mëtejshëm.
 - 0-6 vjeç - 10 fëmijë
 - 6-15 vjeç - 30 fëmijë
 - 15-18 vjeç - 13 fëmijë
 - Fëmijë të komunitetit romë dhe egjiptianë, për të cilët ndërmerren masa për përfshirje dhe pjesëmarrje të barabartë në arsim.

4. Shërbimi i Arsimit bazë dhe të mesëm sipas njësive administrative.

Bashkia Mallakastër ka gjithsej 27 institucione arsimore në të gjitha njësitë administrative

Nr	Njësitë administrative	Shkolla Arsimi bazë	Arsim i mesëm
1	Ballsh	3	1
2	Qendër Dukas	4	
3	Hekal	3	1
4	Fratar	3	1
5	Aranitas	4	
6	Ngraçan	1	
7	Kutë	4	
8	Greshicë	1	
9	Selitë	1	

Paraqitja grafike:



Ndarja administrative në zonat urbane dhe rurale të bashkisë:

- 9 institucione arsimore qendër.
- 18 institucione arsimore vartëse.

Institucionet arsimore qendër kanë këtë ndarje:

- 6 shkolla 9-vjeçare
- 2 gjimnaze.
- 1 shkollë të mesme të bashkuar.



Institucione plotësuese mbështetëse

➤ Bashkia Mallakastër ka në funksionim të plotë Qendrën Kulturore të Fëmijëve, institucion i cili organizohet nga 6 punonjës dhe rreth 46 instruktorë të jashtëm (të ndara në kurse të ndryshme).

Në Qendrën Kulturore të Fëmijëve zhvillohen kurse artistike, kulturore dhe sportive, ku përfshihen një numër i konsiderueshëm fëmijësh të qytetit dhe zonave përreth. Kursantët janë të shpërndarë në profile të ndryshme. Numri i tyre ndryshon nga një kurs në tjetrin. QKF ka progres të dukshëm vit pas viti si qendër formimi, argëtimi dhe zhvillimi për fëmijët e Mallakastrës.

Qëllimi funksional i Qendrës Kulturore të Fëmijëve është edukimi dhe argëtimi i fëmijëve, kultivimi i prirjeve dhe mbështetja e talenteve të tyre si dhe formimi i shprehive dhe shkathtësive përmes kurseve dhe aktiviteteve të ndryshme artistike, kulturore e sportive. Përveç zhvillimit të tyre individual, QKF kontribuon në pasurimin e jetës kulturore të komunitetit duke organizuar festivale, konkurse, veprimtari që nxisin krijimtarinë, pjesëmarrjen dhe integrimin e brezit të ri në jetën shoqërore e qytetare. Institucioni i Qendrës Kulturore të Fëmijëve Mallakastër organizon të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë artistike, kulturore dhe sportive, të cilat financohen nga buxheti i bashkisë Mallakastër.

Sfidat e Qendrës Kulturore të Fëmijëve

Pavarësisht rolit të rëndësishëm që QKF ka në edukimin, argëtimin dhe kultivimin e talenteve të fëmijëve, institucioni përballlet me disa sfida të vazhdueshme si:

- Infrastruktura e pamjaftueshme në ambientet e qendrës që kërkon përmirësim për

tu ofruar fëmijëve kushte më të përshtatshme për mësim dhe ushtrime.

- Mungesa e pajisjeve bashkëkohore artistike, muzikore dhe sportive, të cilat janë të nevojshme për zhvillim cilësor të kurseve.
- Pjesëmarrje e kufizuar e fëmijëve nga zonat rurale, për shkak të distancës dhe vështirësive të transportit.

➤ Gjithashtu në Bashkinë Mallakastër funksionon dhe **Qendra Komunitare Shumëfunktionale** e cila ka për qëllim të sigurojë shërbime të ndryshme sociale, edukative, kulturore dhe komunitare. Në varësi të profilit dhe programeve që ofron, ajo siguron:

- Shërbime sociale: mbështetje për fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre, këshillim psikologjik dhe social, shërbime integruese për persona me aftësi ndryshe.
- Shërbime edukative: kurse dhe aktivitete për zhvillimin e kompetencave shkollore e profesionale
- Shërbime kulturore dhe rinore: organizim aktiviteteve kulturore, artistike e sportive, hapësira për takime dhe zhvillim kreativ, promovim të talentëve të reja
- Shërbime komunitare: hapësirë për bashkëpunim dhe angazhim qytetar, mbështetje për organizatat e shoqërisë civile, projekte për zhvillim komunitar dhe përfshirje sociale.

➤ **Aktivitete të ndryshme të realizuara nga ZVAP në bashkëpunim me Bashkinë Mallakastër.**

Veprimtaritë edukative dhe aktivitetet kulturore – artistike e sportive janë një nga komponentët më të rëndësishme në shkollë. IA kanë zhvilluar disa veprimtari edukative dhe aktivitetet kulturore – artistike e sportive, ku mund të përmendim si më të rëndësishme:

1. Aktivitetet kulturore –artistike me rastin e festave kombëtare.
 2. Konkursi: “Aktiviteti letrar-artistik më i mirë i shkollës”nga aktivitetet për festat kombëtare.
 3. Konkursi Kombëtar “ Gjuha jonë sa e mirë” e cila u zhvillua në rang shkolle ZVAP, DRAP dhe kombëtar. Ku ZVAP u përfaqësua denjësisht në këtë konkurs në të gjitha nivelet në fazën përfundimtare u përfaqësua nga shkolla “Ismail Klosi” Ballsh.
 4. Stop dhunës ndaj grave, vajzave dhe trafikimin e qënieve njerëzore, të organizuara në rang qarku nga Prefektura Fier.
- Prezantimi nga shkollat e mesme me film me metrazh të shkurtër dhe AMU me piktura me akuael.
5. Ekspozita në rang qarku me tematikë ” Parandalimi nga fatkeqësitë natyrore” zjarri, tërmeti, përmytje etj.
 6. Ekspozita “Art dhe Zeje” në tre periudha me pjesëmarrjen e shkollave në rang ZVAP, DRAP, Kombëtar.
 7. Java Olimpikë.
 8. Konkursi me tematikë “Të njohim Europën”

9. Aktivitetet dhe veprimtari të inicuar nga MAS si konkursi për “Festat e Nëntorit”
10. Pjesëmarrja në olimpiadat kombëtare sipas kalendarit të përcaktuar.
11. Pjesëmarrja e nxënësve në kampionatin e Shahut dhe Olimpiadën sportive.
12. Gara sportive ndërmjet shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në disiplinat volejball, futboll.

Aktivitetet u zhvilluan edhe në ditën e te drejtave të fëmijëve, luftës kundër bullizmit, “Tetori muaji i letërsisë”, krijime letrare nga fëmijët, aktivitete me fëmijët me aftësi ndryshe, veprimtari sensibilizuese për ditën e Tokës dhe ditën e Europës, etj.

5. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar.

Vizioni

“Të krijojmë një sistem arsimor parauniversitar gjithëpërfshirës, cilësor dhe inovativ, i cili garanton zhvillimin e aftësive, njohurive dhe kompetencave të nevojshme për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Mallakastër, për të garantuar barazi në mundësi arsimimi në të gjitha njësitë administrative, duke kontribuar në rritjen e mirëqënies dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Qëllimet Strategjike

Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies përmes kurrikulës bashkëkohore dhe metodologjive aktive.

1. Sigurimi i aksesit dhe barazisë në arsim për të gjithë fëmijët, veçanërisht ata nga zonat rurale dhe grupet në nevojë.
2. Përmirësimi i infrastrukturës arsimore për të krijuar mjedise të sigurta, funksionale dhe gjithëpërfshirës.
3. Forcimi i kapaciteteve profesionale të mësuesve dhe stafit drejtues të institucioneve arsimore.
4. Rritja e bashkëpunimit midis shkollës, familjes, bashkisë dhe komunitetit për një edukim sa më efektiv dhe gjithëpërfshirës.
5. Promovimi i talenteve përmes veprimtarive jashtëshkollore.

Synimi

- Garantimi i kushteve të infrastrukturës dhe teknologjisë në çdo shkollë.
- Nxitja e frekuencimit të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor.
- Ofrimi i programeve trajnuese dhe zhvillim profesional për mësuesit e arsimit parashkollor
- Rritja e përqindjes së mësuesve që ndjekin programe trajnimi dhe zhvillimi

profesional.

- Ndërgjegjësimi dhe përfshirja aktive e komunitetit.

Përmbledhje e ndërhyrjeve

1. Infrastruktura

- Rikonstrukcion dhe pajisje të shkollave me laboratorë, kabinete, libra dhe mjete teknologjike.
- Krijimi i ambienteve të sigurta dhe miqësore për fëmijët (kopsht, kënd lojërash, hapësira sportive).

2. Cilësia e mësimdhënies në arsimin parashkollor

- Trajnime të vazhdueshme për mësuesit mbi metodologjitë bashkëkohore.
- Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie.
- Zhvillimi i mekanizmave të vlerësimit të performancës së mësuesve.

3. Aksesimi dhe gjithëpërfshirja

- Mbështetje për nxënësit nga familjet në nevojë me tekste, transport dhe shërbime sociale.
- Programe për përfshirjen e fëmijëve me aftësi ndryshe.

4. Angazhimi i komunitetit

- Forcimi i rolit të këshillave të prindërve në shkollë.
- Organizimi i aktiviteteve edukative, kulturore dhe sportive me pjesëmarrjen e nxënësve dhe komunitetit.
- Partneritete me bizneset lokale për mbështetje të projekteve arsimore.

6. Planifikimi i burimeve financiare

Për zbatimin me sukses të Planit të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë Mallakastër, është thelbësor planifikimi i saktë dhe konkret i burimeve financiare. Ky plan synon të mbulojë realizimin e objektivave dhe aktiviteteve kryesore të planit, të përcaktojë mundësitë për investime në infrastrukturë, përmirësimin e kushteve arsimore, si dhe mbështetjen për nxënësit në nevojë.

• Burimet financiare vendore:

Bashkia mbështet zhvillimin e arsimit përmes të ardhurave vendore dhe fondeve që vijnë nga qeveria qendrore, nga taksat dhe tarifat vendore.

- Arsimin parashkollor, ku mbulohen shpenzimet për pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, si dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së kopshteve dhe çerdheve.
- Arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm të ulët, duke financuar pagat e mësuesve, punonjësve ndihmës, si dhe kostot e objekteve shkollore.
- Shpërblimi i arritjeve për nxënësit me rezultate të shkëlqyera (ekselentët).
- Arsimi profesional përfshin shërbimet për nxënësit e arsimit profesional.

- Aktivitete jashtëshkollore dhe kulturore, që përfshijnë funksionimin e qendrave rinore, kulturës dhe shërbime për fëmijë e të rinj.
- Funksionimin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve ose njësi të tjera mbështetëse të edukimit jashtëshkollor, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë, regjistrohen çdo vit dhe ofrojnë pasqyrë krahasuese për të kuptuar trendet e financimit dhe për të identifikuar boshllëqet në shërbimet arsimore. Këto të dhëna ndihmojnë në vendimmarrje për investime të reja dhe përmirësimin e cilësisë së edukimit në territorin e bashkisë.

Për periudhën 2025-2028, buxheti total i planifikuar për Arsimin Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor është 610.546.763 mijë lekë të detajuara sipas tabelës më poshtë:

Llogaria ekonomike		2025	2026	2027	2028
09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorin					
600	Paga të punonjësve	91.662.522	91.662.522	91.662.522	91.662.522
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	15.307.641	15.307.641	15.307.641	15.307.641
602	Shpenzime për mallra dhe shërbime	9.350.000	9.620.000	9.620.000	9.620.000
230-231	Shpenzime Kapitale të Brendshme	29.557.539	114.898.572	0	0
230-231	Shpenzime Kapitale të Huaja	0	0	0	0
	TOTALI	145.877.702	231.488.735	116.590.163	116.590.163

Për periudhën 2025-2028, buxheti total i planifikuar për Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm është 126.687.427 mijë lekë të detajuara sipas tabelës më poshtë:

Llogaria ekonomike		2025	2026	2027	2028
09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm					
600	Paga të punonjësve	7.279.772	7.279.772	7.279.772	7.279.772
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1.215.722	1.215.722	1.215.722	1.215.722
602	Shpenzime për mallra dhe shërbime	2.290.000	3.140.000	3.140.000	3.140.000
230-231	Shpenzime Kapitale të Brendshme	51.320.707	29674744	0	0
230-231	Shpenzime Kapitale të Huaja	0	0	0	0
TOTALI		62.106.201	41.310.238	11.635.494	11.635.494

Fondet e parashikuara nga transfertat sektoriale për arsimin

Burimet Buxhetore	2025 Plani	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
Konviktet e arsimit parauniversitar	0	0	0	0
Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	87.220.163	87.220.163	87.220.163	87.220.163
Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	19.750.000	19.750.000	19.750.000	19.750.000
Arsimi parauniversitar	8.495.494	8.495.494	8.495.494	8.495.494
TOTALI	115.465.657	115.465.657	115.465.657	115.465.657

- Burime financimi të tjera

Përshkrimi i Politikës së Programeve

09120 - Arsimi bazë (përfshirë sistemin e arsimit parashkollor)

- Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës
- Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve
- Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve
- Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore.

Qëllimi

1. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.
2. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar e lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Objektivi i Politikës së Programit

- Bashkia ofron kushte për përmirësimin e arsimit bazë (9-vjeçar) dhe parashkollor

Standartet e Shërbimeve të Programit

- Shpenzime për paga për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës;
- Programe mësimore për trajnimin e edukatorëve dhe mësuesve;
- Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve.
- Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore.

Përshkrimi i Politikës së Programit

09230- Arsimi i mesëm i përgjithshëm

- Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore.
- Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.
- Shpenzimet për paga për stafin mbështetës.
- Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave.
- Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve.
- Ndërtim dhe mirëmbajtje konviktesh.

Qëllimi

- Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar në arsimin e mesëm të përgjithshëm

Objektivi

- Bashkia ofron kushte për përmirësimin e arsimit të përgjithshëm (mesëm)

Standartet e Shërbimeve të Programit

- Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore,
- Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.
- Shpenzimet për paga për stafin mbështetës.
- Administrim, inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave.
- Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve.

7. Përmbledhje e investimeve kapitale:

Në kuadër të përmirësimit të kushteve të arsimit parauniversitar në Bashkinë Mallakastër parashikohet realizimi i investimeve kapitale të rëndësishme në infrastrukturën shkollore. Përmes këtyre investimeve forcohet lidhja ndërmjet shkollës dhe komunitetit duke e konsideruar arsimin si bazë të zhvillimit social dhe ekonomik të zonës. Realizimi i ndërhyrjeve kapitale përfshin rikonstrukcionin e shkollës “Ismail Klosi” Ballsh dhe të shkollës “Gjokë Doçi” Njësia Administrative Fratar dhe kanë si synim modernizimin e infrastrukturës mësimore, krijimin e hapësirave më funksionale dhe të sigurt si dhe përmirësimin e mjediseve për zhvillimin e aktiviteteve edukative, kulturore dhe sportive.

1. Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh

Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh dhe i terreneve sportive në shkollat e qytetit të Ballshit. Qëllimi për ndërtimin e këtij objekti është krijimi i një godine arsimore me kushte bashkohore dhe komode për nxënësit e kësaj zone në mënyrë që edhe në këtë shkollë të zhvillohet një proces normal mësimor. Ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të institucioneve/objekteve arsimore ekzistuese në arsimin bazë (kopshte/shkolla), që kanë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturën fizike, me qëllim reduktimin/eliminimin e mësimin me turne, përqëndrimin e klasave kolektive, aty ku është e mundur dhe përmirësimin e kushteve të mjediseve arsimore për nxënësit që mësojnë në shkollat 9-vjeçare. Zbatimi i projektit do të ndikojë pozitivisht në cilësinë e infrastrukturës arsimore.

Numri i përfituesve të këtij projekti është:

- Numri aktual i nxënësve të shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” të cilët në total janë 600 nxënës.

- Mësuesit e shkollës të cilët në total janë rreth 30 mësues.
- Numri i banorëve të zonës që përfitojnë drejtpërdrejtë nga zbatimi i projektit është rreth 8000 banorë

Projekti është në listën e projekteve të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, si dhe është në projektet prioritare të parashikuara për zbatim sipas dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mallakastër. Kostoja për mirëmbajtjen e projektit është parashikuar të mbulohet me fondet e vetë Bashkisë Mallakastër, e cila kryen mirëmbajtjes e çdo objekti arsimor në territorin e saj, për të cilin miraton edhe koston përkatëse mirëmbajtëse në buxhetin e çdo viti kalendarik.

2. Ndërtim i shkollës “Gjokë Doçi” Damës.

Qëllimi për ndërtimin e këtij objekti është krijimi i një godine arsimore me kushte bashkëkohore dhe komode për nxënësit e kësaj zone në mënyrë që edhe në këtë shkollë të zhvillohet një proces normal mësimor.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të institucioneve /objekteve arsimore ekzistuese në arsimin bazë (kopshte/shkolla), që kanë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturën fizike, me qëllim reduktimin e mësimit me turne, përqëndrimin e klasave kolektive, aty ku është e mundur dhe përmirësimin e kushteve të mjediseve arsimore për nxënësit që mësojnë në shkollat 9-vjeçare. Zbatimi i projektit do të ndikojë pozitivisht në cilësinë e infrastrukturës arsimore.

Ky projekt synon të përmbushë nevojat e grupeve të mëposhtme të interesit:

- Numri aktual i nxënësve të shkolles 9-vjeçare “Gjokë Doçi” të cilët në total janë 280 nxënës
- Numri i nxënësve që do ti bashkohen kësaj shkolle është 400 nxënës
- Mësuesit e shkollës të cilët në total janë rreth 20 mësues.
- Numri i banorëve të zonës që përfitojnë drejtpërdrejtë nga zbsatimi i projektit është rreth 6000 banorë

Kostoja për mirëmbajtjen e projektit është parashikuar të mbulohet me fondet e vetë Bashkisë Mallakastër, e cila kryen mirëmbajtjen e çdo objekti arsimor në territorin e saj. Projekti është në listën e projekteve të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, si dhe është në projektet prioritare të parashikuara për zbatim sipas dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mallakastër.

Nr	Emërtimi i Projektit	Viti 2025 (000 lekë)	Viti 2026 (000 lekë)	Viti 2027 (000 lekë)
1	“Ndërtimi i shkollës “Gjokë Doçi”	51.320.707	29.674.744	0
2	“Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi “Ballsh”	29.557.539	114.898.572	0

Analizë e investimeve në godinat shkollore

Gjatë viteve 2024-2025, në Bashkinë Mallakastër janë planifikuar dhe realizuar një sërë ndërhyrjesh në godinat arsimore të cilat kanë përfshirë blerjen e materialeve, mirëmbajtjen, riparimet e nevojshme, lyerjet, merimetimet dhe hidroizolimet.

- Në vitin 2024, u planifikua fondi prej 5.000.000 lekë, nga i cili u realizuan 2.518.500 lekë, që përfaqëson afërsisht 50% të planit.
- Në vitin 2025 u planifikua fondi prej 6.205.000 lekë, ndërsa realizimi arriti në 4.473.870 lekë, që përfaqëson afërsisht 70% të planit.

Këto investime kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe të mjediseve shkollore në arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm.

Viti	Planifikuar	Realizuar
2024	5.000.000	2.518.500
2025	6.205.000	4.473.870

8. Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi i planit arsimor parauniversitar është një proces pune që synon të sigurojë informacion për bashkinë dhe palët e interesuara në mënyrë, që të drejtojnë arritjen e objektivave specifike.

Monitorimi shërben për të ndjekur zbatimin e strategjisë së arsimit parauniversitar, për të vlerësuar progresin, për të identifikuar sfidat dhe për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në nivel vendor. Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Mbledhja e të dhënave - sigurimi i informacionit statistikor.
- Analiza e treguesve - krahasimi i objektivave të planit strategjik me ecurinë reale të shkollave dhe institucioneve arsimore.
- Raportimi periodik - përgatitja e raporteve mujore, tre mujore ose vjetore për gjendjen e arsimit parauniversitar dhe përcjellja e tyre tek institucionet përkatëse (Bashkia, ZVAP, DRAP).
- Mbikëqyrja e cilësisë – Monitorimi i standarteve

Vlerësimi

Vlerësimi është një proces i domosdoshëm për të analizuar ecurinë e zbatimit të Planit të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë Mallakastër, duke identifikuar arritjet, vështirësitë dhe mundësitë për përmirësim.

Ky proces shërben për të kuptuar se çfarë ka funksionuar mirë dhe cilat janë aspektet që kërkojnë rishikim, në mënyrë që planifikimi të përshtatet me rrethanat dhe nevojat aktuale

të arsimit në komunitet. Vlerësimi përfshin mbledhjen e të dhënave, analizimin e tyre dhe dhënien e rekomandimeve të bazuara në fakte për përmirësimin e politikave arsimore

Elementet kryesore të vlerësimit:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara
- Informacione periodike
- Tregues mbi ndikimin e investimeve në infrastrukturë dhe cilësinë e shërbimeve arsimore
- Analizë të dhënash të mbledhura nga monitorimi në terren
- Vlerësim të aksesit dhe përfshirjes së nxënësve
- Ndërlidhjen e rezultateve me planifikimet afatmesme dhe afatgjata

Vlerësimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar do të realizohet në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe aktorët lokalë, duke u mbështetur në një proces të vazhdueshëm monitorimi dhe raportimi. Kjo qasje do të garantojë që prioritetet të dakortësohen sipas nevojave reale të komunitetit dhe të orientohen drejt rritjes së cilësisë në arsim.

• **Indikatorët e performancës:**

- Rikonstrukcioni i institucioneve dhe përmirësimi i kushteve.
- Trajnimi i mësuesve dhe edukatoreve. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies me teknologji.
- Zhvillimi i aktiviteteve jashtëshkollore dhe rritja e pjesëmarrjes.
- Mbështetje sociale për fëmijët në nevojë.
- Rritja e efikasitetit të furnizimit dhe mirëmbajtjes së shërbimit.

• **Planifikimi i vlerësimit të progresit:**

- Raportime vjetore mbi aktivitetet e planifikuara.
- Matja e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe shërbime.
- Auditimet periodike që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të politikave arsimore.
- Vlerësimi i qasjes, pjesëmarrjes dhe mjedisit të nxënësve.
- Identifikimi i mangësive apo praktikave të suksesshme që duhen përforcuar.

• **Përfshirja e aktorëve të jashtëm:** Ekspertë të arsimit për vlerësime tematike.

Këshillat e prindërve, drejtues të shkollave dhe komunitetit.

Njësitë e statistikës/performance për monitorim dhe mbledhje të dhënash.

Metodologjia e Monitorimit dhe vlerësimit:

1. Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara.
2. Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor.

9. Rishikimi dhe përshtatja e planit

• **Procesi i rishikimit:**

Për të garantuar që plani i arsimit parauniversitar në Bashkinë Mallakastër të mbetet funksional dhe i përditësuar në një mjedis dinamik social dhe arsimor, është e nevojshme të parashikohet një proces periodik rishikimi. Ky proces do të bazohet në të dhëna konkrete të progresit, rekomandime të aktorëve lokalë dhe analiza të nevojave të reja që shfaqen në terren.

Raportimet mbi planin mund të përfshijnë:

- Rishikim çdo 3 muaj për ecurinë e aktiviteteve;
- Rishikim çdo 6 muaj për raportimet e objektivave strategjike
- Rishikimi vjetor - i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027) – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
- Rishikime të jashtëzakonshme, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Rishikimi i planit duhet të përfshijë përditësimin e objektivave, rishikimin e prioritetëve, përshtatjen e aktiviteteve dhe burimeve. Procesi do të kryhet së paku një herë në vit, në bashkëpunim me grupin hartues të planit, ekspertët e arsimit dhe përfaqësues të komunitetit, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe përshtatshmërisë së tij.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve:

Për një zbatim sa më efikas të planit të arsimit parauniversitar në Bashkinë Mallakastër, është e domosdoshme që masat dhe aktivitetet e përcaktuara të jenë të përshtatura me realitetin lokal. Duke u mbështetur në të dhënat e siguruar nga monitorimi dhe vlerësimi, do të realizohet një rishikim i vazhdueshëm i masave dhe ndërhyrjeve, me synimin për të adresuar çdo vështirësi që shfaqet gjatë procesit të zbatimit. Ky proces mund të përfshijë rishikimin e objektivave të veçanta, riorganizimin e burimeve njerëzore e financiare, ndryshimin e metodave të ndërhyrjes ose shtimin e elementeve të rinj që lidhen me nevoja emergjente të komunitetit.

Për herë të parë u zhvillua projekti JOM, Art, Zeje dhe Sporti në shkollë, ku nga 200 shkolla në rang vendi, dy prej tyre janë pjesë së ZVAP shkolla 'Ismail Klosi' dhe 'Dervish Hekali' Hekal, u përfshinë në këtë nismë.

Në kuadër të këtij projekti prioritet ju kushtua pajisjes së tyre me bazë materiale didaktike për pikturën, instrumenta muzikorë, veshje për korin, tekste letrare dhe materiale për teatrin, veshje artistike, udhëzues praktikë për zhvillimin e aktiviteteve artistike.

Një tjetër nismë e rëndësishme u realizua në bashkëpunim mes MAS, KOKSH dhe bashkisë e cila solli krijimin e ekipeve sportive në shkolla. konkretisht ekipe basketbolli dhe volejbolli,

nismë e cila u pasurua me ekipe të tjera.

Për herë të parë u zbatua nisma “ Siguria në shkolla” në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, duke forcuar masat e sigurisë dhe ndërgjgjesimin e komunitetit shkollor për një mjedis të sigurt.

Të gjitha këto nisma dhe aktivitete, të realizuara në bashkëpunim të drejtpërdrejtë mes Bashkisë dhe ZVAP, kanë ndikuar në:

- përfshirjen e aktiviteteve artistike dhe sportive në shkolla
- rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në aktivitete jashtëshkollore.
- promovimin e sigurisë dhe mirëqënies në institucionet arsimore.

10. Raportimi dhe transparencja

Raportimi i progresit: Në kuadër të zbatimit të planit të arsimit në nivel vendor, një element i domosdoshëm është raportimi i rregullt i progresit, i cili garanton transparencën, llogaridhënien dhe monitorimin efektiv të ecurisë së punës. Për këtë arsye bashkia përcakton formatin, kohëzgjatjen dhe strukturën e raporteve që duhet të hartohen në mënyrë periodike nga njësitë përkatëse përgjegjëse. Përgjegjësia për raportimin e aktiviteteve të realizuara i takon drejtorisë ose sektorëve përkatës, ndërsa në nivel më të gjerë, raportet përmbledhen dhe përcillen tek strukturat më të larta drejtuese. Këto raporte lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e objektivave arsimore dhe sociale që bashkia ka përcaktuar në planin afatmesëm dhe afatgjatë. Raportet hartohen çdo tre, gjashtë ose dymbëdhjetë muaj dhe përmbajnë informacion të detajuar mbi ecurinë e realizimit të objektivave, aktivitetet e kryera, sfidat e hasura gjatë zbatimit si dhe masat korigjuese të ndërmarra.

Përfshirja e publikut: Për të siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe të hapur gjatë zbatimit të Planit të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë Mallakastër, është e nevojshme që informacioni mbi hapat, arritjet dhe vështirësitë të bëhet i aksesueshëm për komunitetin. Kjo transparencë realizohet përmes publikimeve në faqen zyrtare të bashkisë, rrjeteve sociale si edhe mbledhjeve me palët e interesuara. Në këtë kuadër, është me rëndësi që të krijohen mekanizma të posaçëm për konsultim publik ku prindër, mësues, nxënës dhe aktorë të tjerë të përfshirë në proces të kenë mundësi të japin mendimet, idetë dhe vërejtjet e tyre mbi zhvillimin e planit. Publikimi i raporteve ndihmon jo vetëm në llogaridhënien institucionale por edhe në rritjen e përfshirjes së qytetarëve në çështjet e arsimit dhe zhvillimin e politikave vendore.

11. Aneke:

Të dhëna demografike dhe statistikore

Nr. i familjeve për vitin 2014 – 2024 Bashkia Mallakastër

Nr	Viti	Ballsh	Aranitas	Fratar	Greshicë	Hekal	Kutë	Qendër	Gjithsej
1	2014	3443	1113	1895	542	1262	882	2346	11483
2	2015	3478	1137	1934	558	1278	893	2407	11685
3	2016	3533	1155	1975	573	1286	898	2450	11870
4	2017	3585	1157	1980	582	1290	904	2469	11967
5	2018	3593	1141	2027	574	1287	904	2437	11963
6	2019	3476	1102	2008	567	1168	899	2428	11648
7	2020	3465	1098	1996	562	1163	894	2421	11599
8	2021	3359	1096	1987	560	1159	890	2419	11470
9	2022	3647	1196	1959	550	1381	930	2488	12151
10	2023	3678	1199	1961	551	1382	931	2503	12205
11	2024	3694	1211	1987	559	1393	934	2515	12293

Popullsia e regjistruar nga viti 2014 – 2024 Bashkia Mallakastër

Nr	Viti	Ballsh	Aranitas	Fratar	Greshicë	Hekal	Kutë	Qendër	Gjithsej
1	2014	12608	1113	1895	542	1262	882	2346	11483
2	2015	12523	1137	1934	558	1278	893	2407	11685
3	2016	12446	1155	1975	573	1286	898	2450	11870
4	2017	12456	1157	1980	582	1290	904	2469	11967
5	2018	12199	1141	2027	574	1287	904	2437	11963
6	2019	11962	1102	2008	567	1168	899	2428	11648
7	2020	11751	1098	1996	562	1163	894	2421	11599
8	2021	11571	1096	1987	560	1159	890	2419	11470
9	2022	11473	1196	1959	550	1381	930	2488	12151
10	2023	11461	1199	1961	551	1382	931	2503	12205
11	2024	11355	1211	1987	559	1393	934	2515	12293

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATIV

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 57, pika 1
- **Ligji Nr. 69/2012**, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me **Ligjin Nr. 48/2018**
- **Ligji Nr. 139/2015**, “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- **Ligji Nr. 9936/2008**, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 68/2017**, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- **Ligji Nr. 9632/2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- **Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020**, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- **Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023**, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018**, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024**, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- **Ligji Nr. 121/2016**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 18/2017**, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025

- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014**, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MSHMS nr. 658, datë 23.09.2019**, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-social dhe përfshirja Sociale

- **Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020**, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor**, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna për çdo kopsht për periudhën 2023-2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E FËMIJËVE TË REGJISTRUAR NË KOPSHTE DHE ÇERDHE (VAJZA, DJEM)				
	Institucioni	Nr	F	M
1	5 SHKURTI	23	14	9
2	ARANITAS	7	4	3
3	BEJAR	16	11	5
4	BELISTAN	7	5	2
5	DRENOVË QENDËR	7	4	3
6	DRENOVË E RE	5	1	4
7	DRIZAR	5	4	1
8	PANAHOR	5	2	3
9	FRATAR	26	14	11
10	GJERBËS	8	5	3
11	GRESHICË	5	2	3
12	HEKAL	10	7	3
13	I.KLOSI	12	7	5
14	KASH	7	5	2
15	KUTË	5	3	2
16	LAPULEC	5	3	2
17	LAVDAN	6	2	4
18	LOFKËND	5	1	4
19	MOLLAJ	5	3	2
20	NGRAÇAN	6	0	6
21	NINËSH	6	1	5
22	KOPSHTI NR.1	63	31	32
23	KOPSHTI NR.2	57	27	30
24	POÇEM	5	1	4
25	RROMËS	10	5	5
26	VISOKË	7	4	3
	Total nr fëmijëve në kopshte	323	166	157
1	ÇERDHE	28	11	17
	Kopshte + Çerdhe Bashkia Mallakastër	351	177	174

Profili i kopshtit Nr. 1

Emri i kopshtit	
Adresa kopshtit	Lagjja: "5 Shkurti" Ballsh Mallakastër, Nr 23, Rruga Zenel Hekali
Sipërfaqja e ndërtesës së kopshtit	194 m ²
Sipërfaqja e kopshtit bashkë me oborrin	332 m ²
Vjetërsia e ndërtesës (në vite)	
Periudha e rindërtimit (në vite)	
Numri i daljeve	Dalje kryesore: 1 Dalje emergjence: 1
Kapaciteti i projektuar i kopshtit (në nr. i fëmijëve)	Projektuar për afërsisht 150 fëmijë dhe aktualisht janë 63 fëmijë.
Numri total i fëmijëve	Kati i 1-rë: 25 Fëmijë Kati i 2-të: 38 Fëmijë Kati i 3-të: Eshtë ndërtesë dy katëshe.
Numri total i stafit	Gjithsej: 63 Fëmijë Staf pedagogjik: 7 Staf administrativ: 10

Profili i kopshtit Nr 2

Emri i kopshtit	
Adresa kopshtit	Lagjja: "28 Nentori" Ballsh, Mallakastër, Godina Nr.31, Rruga: Ramiz Aranitasi"
Sipërfaqja e ndërtesës së kopshtit	194 m ²
Sipërfaqja e kopshtit bashkë me oborrin	550 m ²
Vjetërsia e ndërtesës (në vite)	
Periudha e rindërtimit (në vite)	
Numri i daljeve	Dalje kryesore: 1 Dalje emergjence: -
Kapaciteti i projektuar i kopshtit (në nr. i fëmijëve)	Projektuar për afërsisht 90 fëmijë dhe aktualisht janë 57 fëmijë.
Numri total i fëmijëve	Kati i 1-rë: 31 Fëmijë Kati i 2-të: 26 Fëmijë Kati i 3-të: Eshtë ndërtesë dy katëshe.
Numri total i stafit	Gjithsej: 57 Fëmijë Staf pedagogjik: 7 Staf administrativ: 13

Disa nga aktivitetet kryesore të zhvilluara në Bashkinë Mallakastër

Nr.	Aktiviteti	Organizator	Partnere	Periudha e zhvillimit	Tematika
1	Fjala Artistike	Drejtoria e Kulturës	ZVAP / Q.K.F	Muaj shkurt	Konkurim artistik dhe promovim i talenteve të reja.
2	Krosi Pranverës	Drejtoria e Kulturës	ZVAP / Q.K.F	Muaj shkurt - Mars	Gare vrapimi / Sport-Jetë.
3	Dita e Mësuesit	Drejtoria e Kulturës	ZVAP / Q.K.F	Mars	Aktivitet festiv. Mërsime mënjohjeje për mësuesit.
4	Dita e Verës	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Mars	Dita e nesjes së një stine të re plot ngjyra
5	Dita Botërore e Sportit për Zhvillim dhe Paqe	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Prill	Promovimi jetës së shëndetshme. Gura dhe argetim
6	Dita e Çlirimit të urrejtimit Ballkë	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Prill	Aktivitet historik-kulturor
7	Dita e Tokës	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Prill	Mbjetllje peme-sh. lryerje me gjelqere, mesazhe sensibilizuese.
8	Dita Botërore e Librit	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Prill	Lexo një libër, dhuro një të tjetër! Referate, diskutime.
9	Kampionati volejbollë	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Prill - Maj	Sport - Kallje - Shëndet.
10	Dita e Europës	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Maj	Pisqa dhe Unëti në Europë.
11	Java Olimpiko	Drejtoria e Kulturës	Q.K.F / ZVAP	Maj	Ndërrimja e sportit me artin, kulturën dhe edukimin.
12	Festa e Fëmijëve	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Qershor	Aktivite argetuese, krijime artistike nga fëmijet
13	Dita Botërore e Mjeshtrit	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Qershor	Fushata sensibilizuese. Ekspozita me punime
14	Dita Ndërkombëtare e Muzikës	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Qershor	Koncerti, shfaqje artistike, promovim i talenteve të rinj
15	Dita e Trashëgimisë Kulturore	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Shtator	Vizita në monumente, aktivite historiko-kulturore
16	Tetori Rozë	Drejtoria e Kulturës	Q.K.F / D.SHP	Tetor	Aktivite sensibilizuese. Disfutura
17	Muaj i Letërsisë	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Tetor	Pasqyrimi i artit pamor në librë, etnografia, ekspozita pëture.
18	Krosi Masiv i Vjeshtës	Drejtoria e Kulturës	Q.K.F / ZVAP	Tetor - Nëntor	Gare vrapimi / Sport-Jetë.
19	Dita e Çlirimit dhe Pavarësisë së Shqipërisë	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Nëntor	Aktivitet historik-kulturor.
20	Kampionati i Basketbollit	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Nëntor - Dhjetor	Sport - Kallje - Shëndet.
21	Dita e Rinisë	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Dhjetor	"E ardhnja jemi ne!" Kontributi i Rinisë në zhvillim dhe perspektivën europiane të vendit.
22	Viti B	Drejtoria e Kulturës	Qendra Kulturore e Fëmijëve	Dhjetor	Aktivitet festiv.

KRYETAR

Qerim Ismailaj

